

Raporti Vjetor

Janar-Dhjetor, 2022



KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim
ZKKK



RAPORTI VJETOR I PUNËS-2022

Hyrje

Ne këtë raport të Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim , janë pasqyruar aktivitetet dhe puna që është kryer në prejdhën 12 muajshë të vitit 2022 .

Këto aktivitete janë zhvilluar sipas planifikimeve të bera të planit vjetor të punës, përkatesisht sipas planifikimeve të aktiviteteve të parapara gjatë tërë vitit.

Synimet kryesore e ZKKK-së për vitin 2022 ishin:

1. Monitorimi dhe realizimi I projekteve për të kthyerit
2. Vizita në Kampet e (Maqedonisë , Malit të Zi , Serbisë) ku jetojnë të zhvendosurit e komunës së Rahovecit.
3. Takimet me përfaqësuesit të komuniteteve nëpër të gjitha lokacione .
4. Monitorimi dhe realizimi i projekteve për Komunitete.
5. Draftimi i planit të veprimit për përfshirjen e komunitetit rom dhe ashkali 2022-2025
6. Draftimi I planit të veprimit për personat e zhvendosur
7. Draftimi I planit të veprimit për personat e riatdhesuar dhe të huaj 2022-2025
8. Takimet/Konsultimi me OJQ dhe OQ mbi projektet , programet dhe aktivitetet në favor të fuqizimit të komuniteteve jo-shumicë.
9. Takimet e rregullta me Policinë e Kosovës dhe KFOR-in .
10. Pjesëmarrja në gjitha komitetet e formuara në kuadër të Komunës .
11. Pjesëmarrja në takime të Komisionit Komunal për Riatdhesim .
12. Bashkëpunim me Ministrin për Kthim dhe Komunitete dhe Ministritë të tjera të Linjës .
13. Bashkëpunim me Ministrin e punëve të Brendshme
14. Përgatitja dhe dalja me Raport mbi gjendjen e komuniteteve Jo shumicë në komunën e Rahovecit.
15. Manifestimi i ditëve Memoriale të komuniteteve në Komunën e Rahovecit .
16. Fushatë /Kampanjë për regjistrimin me Kohë në Shkollë.
17. Hartimi I Buxheti , Planifikimi dhe Propozimi në Komunë.
18. Promovimi i Aktiviteteve që kanë të bëjnë me Fëmijët dhe Barazinë gjinore tek pjesëtarët e Komuniteteve .
19. Renovimi i shtëpive dhe projekteve në fushën e banimit social.

Qëllimi kryesor :

- Përmisimi i gjendjës së Komuniteteve jo-shumicë në Komunën e Rahovecit nga të gjitha segmentet;
- Përmirësimin e infrastruktures , ndriqimit , kanalizimit dhe ujit të pishëm .
- Zhvillimi i aktiviteteve Kulturore , Arsimore dhe Edukative ;
- Fushata sensibilizuese në çështje jetike ,(mbi rëndësin e arsimit) Arsim ,(hixhenës , vaksinimit të rregullt të fëmijëve) Shëndetësi , (parandalimit të dhunës në familje) Barazi gjinore (bahskëpunimit ndëretnik) Multikulturalizëm.
- Ngritjen ,zhvillimin profesional dhe mbështetja me e start up bizneseve për komunitetin jo-shumicë në Komunën e Rahovecit.

Objektivat e përgjithshme :

- Përmirësimi i gjendjës së komuniteteve jo-shumicë , të zhvendosurve , dhe të riatdhesuarve në të gjitha çështjet jetike .
- Implementimi I planit të punës , strategjive të nivelit qendror (për komunitete , riatdhesuar , zhvendosur) , planëve të veprimit .
- Promovimi I kulturës dhe identitetit të komuniteteve jo-shumicë.
- Monitorimi I projekteve Edukative (përfshi funksionalizimin e qendrave të komunitetve , procesit mësimor)
- Përmisimi I infrastrukturës rrugore ku jetojnë komunitetet (kanalizim , kubzim, ndërtim, renovim)
- Zhvillimi dhe bashkëpunimi i aktiviteteve të shumta jashte planifikimeve të planit të punës ;
- Bashkëpunimi me komunitetin dhe me OJQ-te, ;
- Integrimi në procesin edukativo-arsimor i të gjithë fëmijëve të të gjitha komuniteteve pa dallim;
- Aktivitetet që fuqizojnë multikulturalizimin , bashkjetesën ndëretnike , sportive , kulturore dhe educative.

Aktivitetet në periudhën Janar – Dhjetor 2021

- **ARSIM**



Në Komunën e Rahovecit , vijojnë mësimin rreth 100 nxënës nga Komuniteti Rom , Ashkali dhe Egjiptian Rom 3 , Ashkali 77,Egjiptian 20 (6 nga shkolla e mesme) në të gjitha shkollat me system të Republikës së Kosovës .

Program Parale Lagja e eperm & fsh.Hoqe e Madhe /Komuniteti Serbë :

2 Shkolla Fillore : 80 Nxënës , 2 Shkolla të Mesme 14 Nxënës 2 Qerdhe 33 Total : 127 Nxënës .

- ZKKK ka ndërmjësuar në informimin , kompletimin e dokumentacionit dhe procedimin e tyre në ministry për 7nxënës Rom , Ashkali dhe Egjiptian , të shkollave të mesme , për aplikim për bursë me vlerë prej 300 euro nga MASHT.
- ZKKK ka nënshkruar memorandum bashkëpunimin me organizaten ndërkombëtare IOM , mbi Hapjen e “QENDRA MËSIMORE ME BAZË NË KOMUNITET” – në Shkollen multietnike “GËZIM HAMZA-PIKTORI” .
- ZKKK ka realizuar takim me zyrtaret e MASHT-it mbi mundësinë e funksionalizimit , procedurat e aplikimit dhe finalizimit të Qendres me bazë në shkollë .
- Realizimi I vizitave sistematike mbi procesin mesimor të komunitete jo-shumicë dhe parandalimit të braktisjes.

SHËNDETËSI & MIRQENJE SOCIALE

- Duke marrë parasysh rëndësinë , rolin , dhe çështjet që kanë të bëjnë me përmisimin e gjengjës së komuniteteve përmes sektorit të shëndetësisë dhe mirqenjës sociale .
- Në bashkëpunim me akteret e ndryshëm të nivelit qendror , local OJQ-të dhe organizatat ndërmkombëtare , janë realizuar këto aktivitete :
- Fushata vetëdijësuese për vaksinimin anti-Covid-19 - Realizuar nga programi I UNICEF-& BALLKAN SUNFLOËER
- Fushata vetëdijësuese për vaksinim të rregullt të fëmijeve 0-10 vjeq - Realizuar nga programi I UNICEF-& BALLKAN SUNFLOËER.
- Fushata Vetedijësuese me te riatdhesuarit dhe komunitetet jo-shumicë mbi mbrojtjen nga sëmundjet kronike si : Diabeti , Hipertensioni , Semundjet Kronike , si dhe rëndësia e gjdhënjes për fëmijet Realizuar nga programi I UNICEF-& BALLKAN SUNFLOËER.
- ZKKK , ka hapur thirrje për mbështetje me matrial ndërtimor për komunitetet rom , ashkali dhe egjiptian pas bashkëfinancimit të projektit nga OJQ-VORAE & ZKKK.
- Është nënshkruar marveshja për bashkëpunim në për hartimin e planit të veprimit për banimin social në mes të OJQ-VORAE dhe Komunës se Rahovecit.
- Është mbështetur me 6 muaj qira Besfort Hiseni , i cili në dhjetor të vitit 2021 ka pësuar zjarr në shtëpi
- Është caktuar grupi punuës për hartimin e Planit për Banimin Social në Komunën e Rahovecit 2022-2024 .
- Është miratur Plan programi për Banimin Social 2022-2025 nga Asamblea komunale e Rahovecit.
- Jane selektuar 5 përfitues të renovimit të shtëpive në kuadër të marveshtjes OJQ-VORAE & ZKKK.



BARAZI GJINORE :

- Mbajtja e fushatave sensibilizuese mbi parandalimin e dhunës në familje
- Mbajtja e fushatave vetedijesuese për bashkëpronsi të dy gjinive HAREA& PROSPERITETI



- **PUNSIM/STARTUP BIZNES**
- Mbështetja me Paisje për Agrobiznes (kultivuesit e mjaltës) start Up Biznes – Albina Golaj (Egjiptian) Xërxë.
- Mbështetje me Vegla pune dhe Start UP Biznes (Egjiptian) Çifllak Astrit SHALA B.I Organizata Gjermane “HELP”.



RIATDHESIM

- Janë lëshuar për nevoja personale të të riatdhesuarve mbi 40 vertetime (dëshmi që janë të riathdhesuar).
- Është mbajtur komisioni për riatdhesim dhe ka shqyrtuar një rast të cënushëm të riatdhesimit , nëne vetushqyse znj.Hanumshahe Fiedler (e cila është kthyer para 2 viteve por ende mbetet rast cënushëm dhe l pa qëndrushëm).
- Aktualisht po trajtohet dhe kompletohet dokumentacioni për 1 rast të një nëne vetushqyse e riatdhesuar nga Franca , e cila ka nevoj për trajtim të fëmijes me sëmundje të epilepsisë.
- Komisioni për riatdhesim ka dalë në vizitë zyrtare për verifikimin e gjendjës dhe banimit të znj.Vezire Hoxhaj .

KTHIM TË QËNDRUSHËM

- ❑ Priten të trajtohen 10 kërkesa per kthim (që janë ende të pa shqyrtuara) në pritje të programit të ri përkthim RRK-6
- ❑ Është nxerr vendim për komisionin për shqyrtimin e rasteve te kthimit të qëndrushëm 2022-2025.
- ❑ Janë caktuar zyrtarisht me vendim zyrtarët që do të angazhohen në databazën zyrtare për menxhim dheshfrytezim të sistemit për kthim të qëndrushëm .
- ❑ Është në proceduren e draftimit dhe finalizimit –Plani i Veprimit për Kthim të Qëndrushem 2022-2025.
- ❑ Është mbajtur takim më përfaqësuesit e UNHCR dhe Ministrisë për Komunitete dhe Kthim , mbi gjendjen dhe procesin e kthimit , si dhe mundësisë për vazhdimin e prorgamit RRK-6 në të ardhmen.

INFRASTRUKTURË

- Është finalizuar Kanalizimi në lagjën e epërm venbanim multietnik .
- Janë realizuar takime verifikimi të gjendjës në infrastruktur rrugorë në vendbanimet e komuniteteve , dhe janë adresuar project propozime në MAPL- për mbështetje ne kuader të thirrjes publike.
- Është nënshkruar mbështetja e MAPL-së për intervenimin ne infrastrukturë në lagjen e komuniteteve .
- Është intervenuar Çështja e ndriqimit publik në lagjen e epërm në DSHP-ë.
- Kan filluar punimet me kubzim e rruges dhe parkut të fëmijeve në lagjën e komuniteteve tek (Abulanta) .
- Është intervenuar në kapak të pusetave të dëmtuara në lagjet e komuniteteve –“Sylejman Kollari “.



- **SIGURI**
- Pjesëmarrja e stafit të ZKKK-së në 6 takime të Këshillit për Siguri në Bashkësi .
- Me qëllim të angazhimit të të rinjeve që plotësojnë kushtet për rekrutim në Forcen e Kosovës , MAJ. Muharrem Asllani ka ndarë informatat mbi mundësin e komuniteteve jo-shumicë në këtë institucion.
- Me qëllim diskutimit mbi sigurinë në vendë , Shefi I ZKKK-së është takuar me Komandantin e Policisë Kap.Fazli Morina në kuadër të takimeve të parapara sipas planit të punës .
- Janë realizuar takime të rregullta me KFOR-in Britanez dhe Austriak mbi gjendjen e sigurisë së Komuniteteve jo-shumicë .



- **KOMITETI PËR KOMUNITETE**

- Pjesëmarrja e antarëve të ZKKK-së në 6 takime të Komitetin për Komunitete.
- Vizita në Lagjet dhe vendbanimet e komuniteteve jo-shumicë në Komunën e Rahovecit dhe Fshatrat.
- **Raportimi I ZKKK-së për realizimin aktivitetëve të zyrës .**



PJESËMARRJA , NË AKTIVITETE /KONFERENCA DHE AKTIVITETE

- Shefi i ZKKK-së ka realizuar 10 Takime të rregullta me Staffin , me qëllim të implementimit të planit të punës 2022 Kordinimit dhe ndarjen e vazhdueshme të obligimeve , me qëllim të menaxhimit ditor të aktivitetëve .
- Shefi i ZKKK-së ka marrë pjesë në akademin e grave “ËEEK OF ËOMEN “ të organizuar nga NDI-Prishtinë .
- Shefi i ZKKK-së ka marrë pjesë në puntorinë DISICONT të organizuar nga NDI
- Shefi i ZKKK-së ka marrë pjesë në puntorinë online mbi demokracinë të organizuar nga NDI
- Shefi i ZKKK-së ka realizuar takim pune me Ambasadorrin e Kanadasë, me qëllim të bashkëpunimit mbi çështjet që kanë të bëjnë me komunitetet jo-shumicë, respektivisht organizimin e konferencës së donatorëve .
- Shefi i ZKKK-së ka marrë pjesë në puntorinë 2 ditore për të drejtat e grave , të organizuar nga Shtëpia e Sigurtë në rajonin e Gjakovës.
- Zyrtarët e ZKKK-së kanë marr pjesë puntorinë 1 ditorë mbi menaxhimin e data bazës për kthim.
- Shefi I ZKKK-së ka realizuar takime javore me përfaqësuesit e OSCE-së , me qëllim të forcimit të rolit të ZKKK-së, mbështetjes së politikave komunale, zbatuesmerisë së dokumenteve strategjike në favor të komuniteteve .

- Shefi i ZKKK-së ka marrë pjesë në konferencën e organizuar nga SHL Kosova dhe HAREA mbi dhunën në familje .
- Shefi i ZKKK-së ka marrë pjesë në hartimin e planit të veprimit kundër dhunës në familje .
- Shefi i ZKKK-së ka marrë pjesë në intervistimin dhe përzgjedhjen e rekrutëve të rinj në Komunen e Rahovecit .
- Shefi i ZKKK-së ka raportuar mbi situatën e komuniteteve dhe ZKKK-së , në takimin e organizuar nga Kryeministri i Rep.Kosovës zt.Albin Kurti.
- Shefi i ZKKK-së ka takuar Ministrin e MAPL-së zt.Elbert Krasniqi , me qëllim të mbështetjes së projekteve kapitale në vendbanimet e komuniteteve jo-shumicë.
- Shefi i ZKKK-së ka vizituar dhe pritur në vizitë z.Gazmen Salijevic-Zv.Minister për Komunitete dhe Kthim .
- Shefi i ZKKK-së ka takuar në takim pune këshilltaren për çështje të komuniteteve në zyren e Kryeministrit znj.Elizabeth Goëin.
- Shefi i ZKKK-së ka realizuar takim pune me Drejtorin e Financave në Rahovec dhe zv.Ministrin e Financave dhe Trasfereve z.Resul Makreshi , me qëllim të bashkëpunimit dhe intestifikimit të bashkëpunimit në çështjet e komuniteteve dhe lehtësimin e procedurave administrative .
- Shefi i ZKKK-së ka pritur në takim znj.Anita Kalanderi-Alaj , Drejtoresh Ekzekutive të Agjensionit Juridik Falas.
- Janë realizuar 8 takime me përfaqësues të OSCE-së, organizatave shoqërisë civile, Qeverisë së Kosovës dhe organizatave të tjera ndërkombetare me interes komunitet , me qëllim të draftimit të planit të veprimit gjithëpërfshirës për komunitete si politike komunale për avansimin e pozitës së komuniteteve jo-shumicë.

ADRESIMI I KËRKËSAVE NË NIVEL LOKAL, QËNDROR DHE DONATORËVE TË HUAJ :

- Është dorzuar 1 kërkesë në Drejtorinë e Urbanizmit – si bartese e kontratës për renovimin dhe mirëmbajtjen e varrezave , posaqërisht mbi intervenimin e varrezave të dëmtuar vite me parë të komuniteteve rom , ashkali dhe egjiptian .
- Është adresuar 1 kërkesë për renovimin dhe mbështetjen me kompani ndërtimi për shtëpitë në nevojë në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim .
- Është adresuar kërkesë në Drejtorinë e Inspektoriatit , për verifikimin dhe intervenimin në objektet që shkaktojnë rrezik për shembje në vendbanimet e komuniteteve jo-shumicë.
- Janë dorzuar 2 aplikime për mbështetje në Zyren e Kryeministrit për projektet kapitale dhe Arsim.

KONKLuzion

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim , është në process të realizimit edhe shumë propozimeve dhe projekteve që kanë për synim avansimin e pozitës së komuniteteve jo-shumicë në komunën e Rahovecit e që do të realizohen në vitin 2023!

Më posht janë listuar problemet me të theksuara që kërkojnë trajtim me në thukt.

ARSIMI :

Ky segment ndër më të rëndësishëm , e gjenë komunën e Rahovecit relativisht mirë të pozicionuar sa I përket komuniteteve jo-shumicë. aktualisht në komunën e Rahovecit vijojnë mësimet 3 Rom , 77 Ashkali , 20 Egjiptian (6 prej tyre në shkollën e mesme të lartë) total : 100 nxënës në të gjitha shkollat ku banojnë me sistem të Republikës së Kosovës.

Ndërsa komuniteti Serb i cili funksionon në sistemin paralet , i cili është i pozicionuar në dy lokacione në fsht.Hoqë e Madhe dhe lagjën e Epërm, frekuenton 2 Shkolla Fillore :me 80 Nxënës , 2 Shkolla të Mesme me 14 Nxënës , 2 Qerdhe me 33 nxënës Total : 127 Nxënës.

Qëndrushmeria e funksionalizimit të qendrave me bazë në komunitet , ka rëndësi të madhe , momentalisht ajo po funksionon në bazë të rregullorës dhe udhimit administrative për funksionimin e qendrave nga MASHT në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit .

Në menyrë që të rriten kapacitetet dhe cilsia e misionit për këto qendra, duhet të bëhet edhe zgjerimi I aktiviteteve edhe në pjesë të tjera ku jetojnë komunitetet , momentalisht vetëm një qendër funksionon në pjesën rurale gjegjësisht fsht .Ratkoc , duke gjetur momentin që ajo të zgjerohet si tejet e nevojshme edhe në pjesën urbane në lagjën e epërm ku jetojnë një numër I madh I komuniteteve project ky në process të mbështetur nga ZKKK & IOM .

Sfidë e theksuar dhe e gjetur në këtë segment është numri I vogël I interesimit për në shkollat e mesme , nga të dy gjinitë , pavarsisht fushatave që bënë ZKKK për sensibilizimin e tyre, nuk janë treguar të efekshme , duke japë indikacionë që në të ardhmen koncentrimi duhet të bëhet më I thellë I zyrës për të përdorur metodologji të stimulimit përmes mbështetjes me bursa apo stimuleve të tjera që të arrihet shkalla e kënaqshme .

Momentalisht janë duke vijuar studimet vetëm 2 student nga komunitetet rom , ashkali dhe egjiptian , dhe 1 nga komunitetit serbë.

SIGURIA : Deri me tani , vlenë të theksohet që gjendja e sigurisë është e qetë dhe stabile , nuk ka pasur të raportuar për ndonjë incident që shpiie deri te prishja e rendit dhe ligjit , e posaqerisht qe I kontribon destabilizimit nder-etnik.

INFRASTRUKTURA : Infrastruktura rugore , Kanalizimi , Ndriqimi , qasja ne Uje të pishëm , mbetët relativisht e nevojshme , edhe pse në pothuajse të gjitha vendbanimet ka pasur intervenime , por që lë për të dëshiruar më tutje sidomos në sanimin dhe renovimin e kubzimit në disa vendbanime , qasje dhe renovimin e gypave të kanalizimit (lagjën e epërm) , ndriqimin public , si dhe fusha creative e sportive me qëllim të aktivizimit të shoqërisë dhe komunitetit sportiv.

SHËNDETËSIA :

Sfidat e vazhdushëm në këtë segment që ballafaqohen kryesisht individet e komuniteteve jo-shumicë , janë kërkesat e vazhdushëm për tretman shëndetsorë për sëmundjet specifike dhe të pamundura për trajtim përshkak kostos , ato I referojmë në instuticionet qëndrore duke ditur gjendjen e dobët financiare që posedon zyra , por vlenë të theksohet se deri me tani nuk ka pasur ndonjë mbështetje në këtë drejtim , duke arsyetuar me gjendjen e rënduar me COVID-19 ,dhe përkushtimit instuticional për gjendjen në fjalë.

Vlenë të theksohet që në kuadër të fushatave sensibilizuesë që ka mbajtur shoqeria civile në bashkëpunim me zyrën , janë vaksinuar një numër I madh e komuniteteve me vaksina të ndryshme në përdorim .

Në këtë segment duhet të mbështeten më shumë përsonat që lëngojnë nga sëmundjet e rënda dhe kërkojnë tretman jasht shtetit , duke gjetur metoda dhe vullnet më të madhë nga instuticionet publike për të ndarë një linjë buxhetore nga të gjitha nivelet e përgjegjësisë.

BANIMI/BANIMI SOCIAL : Aktualisht ka shumë familje të identifikuara që kanë nevojë për renovim të shtëpisë nga gjendja e rëndë fizike , mbështetje me matrial ndërtimor , dhe ndërtim të shtëpisë nga fillimi .

Nevojat e shumta të tyre kan rënduar edhe më shumë për disa familje që jetojnë me kushte tejet të rënda dhe me ndihmë sociale , duke shtuar këtu edhe jo-pronsine në parcellat e tyre , si parakushti kryesor për ti ndihmuar.

Deri me tani Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim , ka referuar dhe mbështetur disa raste në nevojë , por duke ju referuar buxhetit të vogël që ka zyra , në pa mundësi për të mbështetur , ajo ka adresuar kërkesa të kohë pas koshmë edhe në nivelin qëndorë.

Aktualisht komuna e Rahovecit nuk ka në dispozicion ndonjë banim kolektiv social , në mënyrë të jap hapsirë për përsonan në nevoje .

REKOMANDIMET DHE NEVOJAT E ZYRËS :

- RITITJA E BUXHETIT DHE SHTIMI I ZËRAVE BUXHETOR (SUBVENCIONE)
- RITITJA E KAPACITETEVE TË STAFIT –ANGAZHIMI I STAFIT SHITESË .
- VETURA PËR TEREN DHE FURNIZIMI ME PAISJE TEKNOLOGJIKE (printer , skaner , laptop etj) .



Dhjetor 2022, Rahovec